

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AGIS-ApiTerapi” sh.p.k

Sot nw datwn 31.01.2022, Themeluesi **Genci ISMAILI**, i biri i Nazmi, lindur në Skrapar më 28.12.1973 dhe banues në Sauk i Ri, Rruga “Ernest Bushat” Tiranë, me ID nr.personal H31228045T bazuar në këtë Akt Themelimi, bazuar në parimet e mëposhtme ka vendosur krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin **“AGIS-ApiTerapi” sh.p.k**

Neni 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“AGIS-ApiTerapi” sh.p.k.**

Kjo shoqëri e këtij lloji do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në statut nga ortaku i vetëm.

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë është; *ish Kantieri i Pyjeve Luadh, Gjerbës, Skrapar, ZK 2495, Rurale.*

Shoqëria mund të ketë filiale në rrethe të tjera të vendit, apo përfaqësi e degë për kryerjete aktivitetit edhe jashtë territorit të Shqipërisë. Miratimi i degëve ose filialeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të bëhet pas miratimit nga organet kompetente të vendit dhe me kryerjete veprimeve ligjore në organet e përcaktuara me ligj. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm ose, në rast të shtimit të ortakëve me vendim të Asamblesë së zakonshme të Ortakëve të saj. Për këtë ndryshim do të vihen në dijeni organet shtetërore përkatëse, për të bërë ndryshimet e duhura.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë, në fushën e ndërtimit të objekteve civile, apo punime konstruktive e resatauruese, kryerjen e aktiviteteve në Agroturizëm dhe shërbimet turistike, kryerjen e trajtimeve me ApiTerapi, mbarështimi i bletës dhe nënprodukte të tyre, kryerje e punimeve civile apo rikonstruksionin e banesave dhe objekteve ndërtimore, në zona të banuara apo në zona të mbrojtura mjedisore sipas Ljeve të organeve shtetërore, kryerja e ndërtimeve të drurit me karakter hotelerie apo per kurim me bletë, shërbime në bare e restorante, shërbime konsulente në fushën e pronësise apo shitblerje Imobiliare, kryerjen e Agjencisë apo shërbimit postar, kryerja e kurseve mësimorë apo për marrjen e Lejeve të drejtimt të automjeteve, e pasurive të paluajtshme, kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit dhe shërbimit për agjenci turistike, tregtimin e biletave të transportit detar apo ajror, informacine dhe guida turistike, hapjen e degës të agjencive të sigurimeve, duke përfaqësuar shoqëritë e sigurimeve, sipas Lejeve dhe kontratave përkatëse.

Si objekt të veprimtarisë së saj, shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj, që lejohet nga ligjet e shtetit ku ushtrohet aktiviteti dhe që kanë rëndësi për të ardhmen e shoqërisë.

Neni 4

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimtarisë me afat të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë e saj përpara këtij afati në rastet e prishjes ose likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", por vetëm pasi për këtë të ketë vendosur Ortaku i vetëm apo në rast të shtimit të ortakëve, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR



Kapitali themeltar i Shoqërisë "AGIS-ApiTerapi"Sh.p.k, do të jetë 100 000 (njëqind mijë lekë të reja) i zotëruar tërësisht nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë, Genci ISMAILI.

I gjithë kapitali i shoqërisë prej 100 000 (njëqind mijë lekë) përfaqëson 1 kuotë me 100 000 lekë, të cilat përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë me 100% të kuotave të kapitalit.

Neni 6

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie midis trashëgimtarëve ligjorë të ortakut të vetëm themelues. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rastet për ndarje pasurore mes bashkëshortëve, si dhe ndërmjet pasardhësve e paraardhësve të tij.

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të ortakut të vetëm themelues do të bëhet me Vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë për veprime të shitjes apo transferime kapitali në forma të tjera ligjore. Me shtimin e ortakëve të shoqërisë, dhe ne rast vdekjeje të ndonjë prej ortakëve të shoqërisë, trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit të shoqërisë ose për vazhdimin e veprimtarisë, duke respektuar dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 7

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Funksioni ekzekutiv i administrimit dhe menaxhimit të shoqërisë ushtrohet nga Administratori i shoqërisë, i cili do të jetë z. Genci Ismaili, i cili është edhe ortak i vetëm i saj. Ai do të ushtrojë funksionin e administratorit për një afat prej 5 vjet.

Në rastin kur ortaku i vetëm ose Asambleja e ortakëve, me shtimin e ortakëve të shoqërisë, cakton një administrator tjetër të shoqërisë jo ortak të shoqërisë, afati kohor për ushtrimin e këtij funksioni është 1 vit, me të drejtë rizgjedhje. **Neni 8**

VULA DHE STEMA

Shoqëria ka vulën e saj, në të cilën është shkruar: *Shoqëria private "AGIS-ApiTerapi"sh.p.k* Skrapar - ALBANIA. Vula ka formë vezake, me stemën e saj dalluese, dhe administrohet dhe disponohet nga Administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë.

Shoqëria ka stemën e saj të veçantë të dallueshme nga shoqëritë e tjera. Të gjitha shkresat që formulohen dhe dalin nga shoqëria duhet të nënshkruhen nga administratori dhe të vulosen me vulën e shoqërisë. Shoqëria do të ketë edhe ëbsite e saj elektronik, i cili do të administrohet nga Administratori.

Neni 9

DISPOZITA TË FUNDIT

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelimi edhe me normat e përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues përpara noterit e më pas do të kërkohet depozitimi i tyre në QKB. Pas miratimit të tyre nga QKB, do të bëhet edhe legalizimi si person juridik në Shqipëri i kësaj shoqërie.

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky Akt Themelimi dhe Statuti përkatës do të vlejnjë dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" seksioni për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe aktet e tjera ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj shoqërie.

Neni 10

Ky akt themelimi është hartuar në 3 kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njëjtë ligjore. Një kopje depozitohet në QKB dhe Kopjet e tjera do të qëndrojnë në selinë e shoqërisë si dokument themelor i krijimit të shoqërisë "AGIS-ApiTerapi"Sh.p.k.

Ortaku Themelues

Genci ISMAILI,

